

VENDIM
Nr. 659, datë 6.12.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 141, DATË 22.2.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
AUTORITETIT KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE
SIGURINË KIBERNETIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 7, të nenit 10, të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 141, datë 22.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, të ndryshuar, pika 6/2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6/2. Drejtori i përgjithshëm mbështetet nga 2 (dy) zëvendësdyrektore të përgjithshëm, të caktuar nga drejtorët e emëruar të drejtorive të përmbajtjes së Autoritetit, të cilët, krahas detyrave funksionale, kryejnë çdo detyrë tjetër të caktuar nga drejtori i përgjithshëm për ta mbështetur atë në mbarëvajtjen e institucionit.”.

2. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku